

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN DOGANORE MORINË, KUKËS.

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës, Morinë, me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor” për periudhën viti 2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 141, datë 30.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 728/10, datë 30.09.2014 dhe nr. 728/9, datë 30.09.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar znj. Elisa Spiropali, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave, Tiranë dhe z. Edvin Kepi, Kryetar i Degës Doganës, Morinë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A-MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi u konstatua se, nga Dega Doganore Morinë, nuk janë vendosur në funksionim disa kërkesa e detyrime ligjore të implementimit të sistemeve të përshtatshme të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk është hartuar një sistem rregullash dhe procedurash në njësinë e vartësisë, nuk është hartuar plani strategjik vjetor, nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut, nuk është hartuar plani i veprimeve për arritjen e objektivave, nuk është ngritur grupi i menaxhimit strategjik të njësisë ku në krye të jetë titullari i njësisë, jo në përputhje me kërkesat e të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, *sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 42-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë rekomandojmë:*

Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Morinë të marrë masa që të hartojë planin strategjik vjetor, të hartojë strategjinë e menaxhimit të riskut, të hartojë planin e veprimeve për arritjen e objektivave dhe të ngrihet grupi i menaxhimit strategjik ku të kryesohet nga titullari, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

2. Nga auditimi u konstatua se, nga Dega Doganore Morinë, nuk janë miratuar akte të brendshme administrative për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve, për të siguruar ngritjen dhe zbatimin e rregullave për kontrollin e brendshëm të njësisë, jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, *sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 42-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë rekomandojmë:*

Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Morinë të miratojë aktet e brendshme administrative për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të njësisë dhe për zbatimin e rregullave për kontrollin e brendshëm bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

3. Nga auditimi u konstatua se, në Degën Doganore Morinë, nuk disponohen dosje investigimi për subjekte të ndryshme të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm e të nevojshëm, me qëllim pranimin e çmimit me transaksion, në përlogaritjen e vlerës doganore, veprime që nuk përputhen me kërkesat e neneve 34-40 të KD, Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 si edhe me të dhënat e disponueshme të miratuara nga komisioni i Ministrisë së Financave.

Praktikat doganore, të realizuara nga Dega e Doganës Morinë, nuk janë shoqëruar me procesverbal mbi vlerësimin e indikatorëve në kundërshtim me nenet 285, 286, 287 e vijim të Kodi Doganor, si dhe me Udhëzimin nr. 25, datë 13.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes më të dhëna të

disponueshme dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”, si dhe në zbatim të Kodit Doganor nenet 34 “vlera e transaktuar” dhe 35/a “vlera e mallrave identike”, *sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 12-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë rekomandojmë:*

Autoriteti Doganor Kompetent Dega e Doganës Morinë të marrë masa që praktikatat doganore, të pranuar me transaksion në përcaktimin vlerës për qëllime doganore, të mbështeten me procesverbale vlerësimi të indikatorëve në zbatim të neneve 285, 286, 287 e vijim të Kodi Doganor, si dhe të Udhëzimit nr. 25, datë 13.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes më të dhëna të disponueshme dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre” pika 6, në të cilën thuhet: “Përcaktimi i vlerës së artikullit bazuar në pikat e mësipërme, gjithmonë duhet të shoqërohet nga një procesverbal sipas shtojcës bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku duhet të plotësohen indikatorët e kontrolluar...” si dhe në zbatim të Kodit Doganor nenet 34 “vlera e transaktuar” dhe 35/a “vlera e mallrave identike”.

4. Nga auditimi u konstatua se, në Degën Doganore Morinë dokumentacioni shoqërues i praktikave doganore, të pranuar për vlerësim nga administrata doganore, janë dokumente fotokopje si fatura e shitjes, CMR, deklarata e eksportit, certifikata e origjinës, lista e paketimit, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Dispozitat Zbatuese” dhe Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007. Në praktikatat doganore nuk janë bashkëlidhur librezat e mjeteve transportuese, apo certifikata e peshimit bosh me qëllim përcaktimin e saktë të peshës bosh (tarës) të mjetit, kapacitetit mbartës të tij, si dhe të peshës bruto e neto të mallit të importuar dhe eksportuar të pasqyruara në përlogaritjen e shpenzimeve të transportit e të vlerës së mallit, *sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 12-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë rekomandojmë:

Autoriteti Doganor Kompetent Dega e Doganës Morinë të marrë masa për ndalimin e menjëhershëm të përdorimit të dokumenteve shoqëruese të praktikave doganore që paraqiten për zhdoganim nga operatorët ekonomik dhe pranohen për vlerësim nga administrata doganore, në formën dokumente fotokopje të tilla si fatura e shitjes, CMR, deklarata e eksportit, certifikata e origjinës, lista e paketimit në raste të veçanta edhe Euro 1, veprime këto që bien në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Dispozitat Zbatuese” dhe udhëzimi nr. 25, datë 30.11.2007, i Ministrisë të Financave.

5. Nga auditimi u konstatua se, nga Dega Doganore Morinë, për mallrat të cilat nuk kanë të dhëna të disponueshme (apo të dhëna të disponueshme të dërguar nga DPD) si dhe për mallrat e përdorura nuk është nxjerrë urdhër nga dega doganore për miratimin dhe funksionimin e komisionit të vlerësimit, ku për vendimet e marra nga ky komision duhej të ishte njoftuar menjëherë DPD, në zbatim të pikës 54-81 të VKM nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese të KD” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 “Për vlerën doganore”, udhëzimit nr. 6, 6/1/2 të DPD “Mbi vlerësimin doganor”, *sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 12-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë rekomandojmë:*

Autoriteti Doganor Kompetent Dega e Doganës Morinë të nxjerrë menjëherë urdhrin e brendshëm për funksionimin e Komisionit të Vlerësimit Doganor, për të vlerësuar mallrat për të cilët nuk kanë të dhëna të disponueshme të dërguar nga DPD, si dhe për mallrat e përdorura.

6. Nga auditimi me zgjedhje u konstatua se, në Degën Doganore Morinë, paraqiten një numër tranzitësh të pambyllura në sistem si dhe në shumë raste Tranzitet Ndërkombëtare janë mbyllur me shumë vonesë e jashtë kohës limitit të mbërritjes në destinacion, nuk është paraqitur dokumentacion justifikues për vonesat nga ana e Degës Doganore Morinë dhe nuk janë aplikuar penaltetet përkatëse. Konkretisht nga auditimi me zgjedhje mbi afatet e mbylljes së tranziteve për periudhën 6/mujorin e parë të vitit 2013 rezultoi se: në 26 raste nuk janë aplikuar penaltetet

përkatëse në shumën 37,014,000 lekë, *sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 29-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë rekomandojmë:*

Autoriteti Doganor Kompetent Dega e Doganës Morinë të marrë masa për evidentimin e tranziteve të pambyllura në sistem dhe mbylljen e tyre, si dhe për Tranzitet Ndërkombëtare të mbyllura me vonesë e jashtë kohës limitit të mbërritjes në destinacion, të përcaktohen e vendosen penalitetet përkatëse sipas rasteve për vitin 2013.

7. Nga auditimi u konstatua se, në Degën Doganore Morinë gjendja e borxhit doganor është në nivele të larta dhe me tendencë në rritje, arkëtimi dhe vjelja e debitorëve është në nivele të ulta dhe është si rrjedhojë e një pune të pamjaftueshme në: Mos zbatimin e plotë të kërkesave të legjislacionit për rikuperimin e borxhit doganor nga ana e autoritetit doganor kompetent; Bashkëpunim i pamjaftueshëm midis Degës Doganore me strukturat e D.P. Doganave dhe me institucionet e tjera me detyrim e kontribut në arkëtimin e borxhit siç janë; Zyrrat e Përmbarrimit, Sistemin Bankar, Z.R.P.P., D.SH.T.RR. etj., *sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 34-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. Për këtë rekomandojmë:*

Autoriteti Doganor Kompetent, Dega e Doganës Morinë të analizojë gjendjen e debitorëve, të përdoren të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore me program pune të posaçëm dhe me afate konkrete dhe të merren të gjitha masat për rikuperimin e borxhit doganor të mbetur pa rikuperuar ***në vlerën prej 61.202 mijë leke.***

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Dega e Doganës Morinë, të kryejë kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerë prej **4,551,366 lekë** si më poshtë;

1. Vlera prej **1.727.076 lekë**, nga subjekti [REDAKTUAR] në **24 raste**, sipas pasqyrës nr. 1 bashkëlidhur e të trajtuar në faqet 12-29 të Raportit të auditimit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penaliteteve sipas Kodit Doganor, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore.

2. Vlera prej **85.699 lekë**, nga subjekti [REDAKTUAR] në **2 raste**, sipas pasqyrës nr. 2 bashkëlidhur e të trajtuar në faqet 12-29 të Raportit të auditimit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penaliteteve sipas Kodit Doganor, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore.

3. Vlera prej **105.150 lekë**, nga subjekti [REDAKTUAR] në **2 raste**, sipas pasqyrës nr. 3 bashkëlidhur e të trajtuar në faqet 12-29 të Raportit të auditimit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penaliteteve sipas Kodit Doganor, për mos përfshirjen e shpenzimeve të transportit në vlerën e mallit për qëllime doganore.

4. Vlera prej **1.391.890 lekë**, nga subjekti [REDAKTUAR] në **98 raste**, sipas pasqyrës nr. 4 bashkëlidhur e të trajtuar në faqet 12-29 të Raportit të auditimit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penaliteteve sipas Kodit Doganor, për mos përfshirjen e shpenzimeve të transportit në vlerën e mallit për qëllime doganore.

5. Vlera prej **343.010 lekë**, nga subjekti [REDAKTUAR] në **9 raste**, sipas pasqyrës nr. 5 bashkëlidhur e të trajtuar në faqet 12-29 të Raportit të auditimit për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penaliteteve sipas Kodit Doganor, për mos përfshirjen e shpenzimeve të transportit në vlerën e mallit për qëllime doganore.

6. Vlera prej **812,241 lekë nga 3 persona**, për përdorimin e automjetit jashtë nevojave funksionale të degës doganore, jo në përputhje me përcaktimet dhe kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me Rregulloren e brendshme nr.14443/1 dhe 14443/2 prot, datë 12.09.2012 “Për përdorimin e automjeteve të sistemit doganor”, neni 3 pika 1 dhe 2, neni 5 pika 5.

7. Vlera prej **26.300 lekë** nga subjektet sipas regjistrimit të parkimit në Degën Doganore Morinë. Për mos arkëtimin e tarifës së parkimit të automjeteve të ndryshme në parkingun e doganës, jo në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

8. Vlera prej **60.000 lekë** nga subjektet sipas regjistrimit të peshimit në Degën Doganore Morinë. Për mos arkëtimin e *tarifës së peshimit për* mjetet që peshohen kur kalojnë në pikën doganore Morinë, jo në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe me kërkesat e Urdhrit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me nr. 2307 prot. datë 7.4.2006 “Mbi përdorimin dhe administrimin e peshoreve”, pika 6.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Drejtores së Përgjithshme të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore Morinë, Kukës, që në vlerësimin e shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda e shumë të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin e dhënien e masave përkatëse sipas nenit 59 të ligjit nr. 152/2013, **nga “mbajtja deri 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”, deri “largim nga shërbimi civil” për 2 (dy) punonjës**, si më poshtë:

1. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-Kryetar Degës Doganore, aktualisht Specialist/Analizë Risku/Aposterior, për shkeljet e konstatuar në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara,
-Për problemet e mos zbatimit të plotë të kërkesave të legjislacionit për rikuperimin e borxhit doganor, nga ana e autoritetit doganor kompetente. Veprime që përbëjnë shkelje të: ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” neni 18 pika 4, neni 245 pika 1 germa a, pika 2 germa a dhe b, pika 4; Udhëzimi i DPD-së nr. 4, date 04.08.2006 dhe nr.6, datë 23.07.2013 “Për Zbatimin Praktik të Procedurës së Evidentimit, Kontabilizimit dhe Vjeljes së Borxhit Doganor me ndryshimet” pika 8; Rregullores së Brendshme të DPD-së nr. 10168 prot., datë 07.06.2011. (*mbajtur procesverbali nr. 5, datë 28.08.2014*)
-Për problemet e konstatuara në rastet e konfiskimit dhe sekuestrimit të mallrave dhe materialeve, të cilat janë bërë hyrje në magazinë me vonesë, në vitin pasardhës, dhe nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2013, jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 34 dhe 39. (*mbajtur procesverbali nr. 2, datë 26.08.2014*)
-Për problemet e konstatuar në lidhje me përdorimin e automjetit jashtë nevojave funksionale të Degës Doganore, pa plotësuar dokumentacionin e kërkuar ligjor, duke harxhuar gjithsej 1,127 litra Naftë D1, në vlerë 205,950 lekë, jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9936 datë

26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me Rregulloren e brendshme nr.14443/1 dhe 14443/2 prot, datë 12.09.2012 “Për përdorimin e automjeteve të sistemit doganor”, neni 3 pika 1 dhe 2, neni 5 pika 5. (Për s a m ë l a r t ë s h t ë m b a j t u r p r o c e s v e r b a l i n r. 1, datë 21.08.2014)

2., në cilësinë e Do ganier Vlerësim/Klasifikim/Kontroll Fizik, për shkeljet e konstatuar në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara,

- Për problemin e konstatuar në lidhje me mbylljen e tranziteve në sistem jashtë kohës limitit të mbërritjes në destinacion dhe mos aplikim penalitetet përkatëse, veprime në kundërshtim me ligjin nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, nenet 114-120 dhe neni 260; VKM nr.205 datë 13.04.1999 “Për Disp ozitat Zbatuese të Kodit Doganor” pikat 182- 233 dhe shkresa e DPD nr. 18019 prot. datë 24.10.2012 “Urdhër mbi Çiftosjen e Deklaratave të Tranzitit”.(m b a j t u r p r o c e s v e r b a l i n r. 6, datë 28.08.2014)

Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për 19 (nëntëmbëdhjetë) ish-punonjës nuk rekomandohet masë pasi janë të larguar nga sistemi doganor. Masa e propozuar do të ishte “vërejtje”.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Artan Mirashi, p/grupi, Aqif Klosi dhe Hekuran Avdulaj, më tej u shqyrtua nga Kryeauditues z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano. Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Dega e Doganës, Morinë me shkresën nr. 728/11, datë 30.10.2014 ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve nga ku rezulton se është hartuar Plani i Punës për zbatimin e rekomandimeve dhe ka dalë Urdhër i Brendshëm nr. 2453/1, datë 06.10.2014, ku janë vlerësuar dhe janë zbatuar 6 masa organizative të rekomanduara si dhe 1 është në proces. Për 8 masat për shpërblim dëmi të rekomanduara kanë dalë vendimet administrative dhe ka filluar procedura e rikuperimit të borxhit doganor për 6 prej tyre në shumën 2,012,049 lekë për një masë në shumën 1,727,076 lekë është kërkuar nga DPD verifikimi i faturave dhe për një masë në shumën 812,241 lekë nuk ka dalë vendim si dhe nuk ka filluar akoma procesi disiplinor për dhenien e masës disiplinore për dy punonjësit e propozuar.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT